REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli):

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë".

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli):

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë".

Naureda Llagami: Përshëndetje, po fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 2 nëntor.

Siç jeni në dijeni në rendin e ditës janë 9 çështje për t'u marrë në shqyrtim nga ana e Këshillit.

Paraprakisht dëshiroj t'ju informoj që nga ana e zonjës {...}, që ishte parashikuar shqyrtimi sot i dy projektraporteve të vlerësimit, është parashtruar që është në pamundësi për të ardhur sot në këtë seancë për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë dhe ka bërë dijeni Këshillin lidhur me pamundësinë që ka. Kështu që, për këtë arsye, sugjerojmë, duke qenë se zonja {...} ka kërkuar që të dëgjohet në seancën e vlerësimit të raportit të saj, sugjerojmë që kjo çështje të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Marçela Shehu: Kryetare më fal.

Në lidhje me rendin e ditës unë do të propozoja që pika 5 e rendit të ditës, pika 6 dhe pika 7 e rendit të ditës, të shtyheshin për shqyrtim në një mbledhje tjetër. Pse e paraqes këtë kërkesë dhe këtë propozim?

Rezulton se këto tre pika të rendit të ditës lidhen me shqyrtimin e projektvendimeve për vlerësimin etik dhe profesional të dy kandidatëve për në Gjykatën e Lartë, konkretisht të zotit {...} dhe të zonjës {...}, të cilët së bashku me dy gjyqtarë të tjerë, zonjën {...} dhe zonjën {...}, kandidojnë për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin me nr. 535, nr. 536, nr. 537. Pra kemi katër kandidatë që kandidojnë për tre pozicione të lira.

Pa vënë fare në diskutim të gjithë objektivitetin, profesionalizmin e Këshillit në

hartimin e projekraporteve dhe në miratimin e vlerësimeve përkatëse, por për ta transmetuar sa më qartë të gjithë këtë objektivitet, paanshmëri, profesionalizëm, për të shmangur qoftë edhe në mënyrë hipotetike çdo dyshim apo çdo aludim nga kandidatët apo edhe nga gjyqtarët e tjerë, unë do të propozoja, gjithsesi kjo mbetet në vlerësimin e Këshillit (është vetëm mendimi dhe propozimi im), që projektraportet e vlerësimeve profesionale për këta katër kandidatë të shqyrtohen në të njëjtën mbledhje ose në një periudhë të afërt. Ky është mendimi dhe propozimi im. Gjithsesi i mbetet Këshillit për ta vlerësuar.

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, lidhur me propozimin e zonjës Shehu, unë jam dakord që për sa kohë zonja {...} është gjyqtarja që ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe ajo ka një shkak të përligjur për të mos qenë prezent sot në seancë, shqyrtimi i dy projektvendimeve për vlerësimin e saj etik dhe profesional për periudhat përkatëse nuk mund të vijojë nga ana e Këshillit, kështu që dakordësohem me pjesën që shqyrtimi i këtyre dy projektvendimeve të shtyhet për një mbledhje të radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me propozimin e zonjës Shehu për të shtyrë shqyrtimin e projektvendimit për gjyqtarin {...}. Në fakt, projektraporti i vlerësimit bashkë me kundërshtimet që ka bërë gjyqtari ka kohë që i është dërguar të gjithë gjyqtarëve në adresat elektronike. Gjyqtari nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe në vlerësimin tim nuk ka pengesë për të vijuar sot shqyrtimin e projektraportit të vlerësimit. Kundërshtimet e gjyqtarit rreth projektraportit janë bërë. Ai ka parashtruar në mënyrë të hollësishme dhe kundërshton vetëm dy nga treguesit e projektraportit të vlerësimit dhe nga ana tjetër unë mendoj që integriteti etik profesional i anëtarëve të Këshillit është i tillë që nuk ka pse të krijojë aludime apo perceptime për të tjerët për trajtime të diferencuara në projektraportin e vlerësimit. Nuk do të ketë asnjë ndryshim (mendoj unë) për anëtarët e Këshillit si t'i trajtojë bashkërisht në një mbledhje, si t'i trajtojë në mënyrë të veçantë. Aq më tepër, praktika ka treguar që ngarkesa shumë e madhe në projektraportet e vlerësimit e bën të pamundur edhe diskutimin dhe përfundimin e tyre në një mbledhje të përbashkët.

Kështu që nuk dakordësohem me propozimin e zonjës Shehu për nxjerrjen nga

rendi i ditës të pikës 5, të akteve që janë sot për shqyrtim. Faleminderit!

Naureda Llagami: E hedhim në votim propozimin e zonjës Shehu.

Ilir Rusi: Kundër propozimit të zonjës Shehu.

Irena Plaku: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord me propozimin e zonjës Shehu.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër, me arsyen që këto rregulla nuk duhet t'i vendosim për emra dhe persona të veçantë, por në qoftë se duhet ta bëjmë rregull duhet ta bëjmë në të tëra rastet. Meqenëse ky është rasti i parë, do bëhet diferencim me të gjithë ato kandidatura të tjera që ne i kemi shqyrtuar më parë në Këshill. Kështu që e diskutojmë paraprakisht para çdo vendi që duhet të shpallet që nëse duhet të vendosim të tilla rregulla i vendosim, mos t'i lidhim me emrat.

Marçela Shehu: Dakord. Propozimi nuk kishte lidhje as me emra, as me pozicione konkrete. Ishte sot rasti për ta ngritur si diskutim në mbledhje plenare, ndonëse jo formalisht unë e kam diskutuar dhe e kam ngritur disa herë me kolegët këtë vlerësim. Është një mendim dhe propozim i imi duke vlerësuar dhe në respekt të postulatit që drejtësia jo vetëm të bëhet (se nuk kam pikë dyshimi që bëhet dhe nuk kam pikë dyshimi tek integriteti i secilit anëtar të Këshillit), por drejtësia dhe ky integritet dhe kjo paanshmëri, edhe të duket dhe të transmetohet si e tillë. Jam dakord.

Yllka Rupa: Kundër propozimit.

Brikena Ukperaj: Kundër propozimit, me argumentimin që sapo thashë.

Klodian Kurushi: Atëherë, me sa kuptova unë tek propozimi që bëri Marçela, nuk kishte fjalë vetëm për këto të dy. Domethënë ideja ishte që a duhet të vendosim, as për një ditë kam përshtypjen, ose të paktën unë ndaj këtë qëndrim...

Marçela Shehu: Propozimi ishte në të njëjtën datë ose në një periudhë të afërt. Mbase jo në të njëjtën seancë. Ishte për të katër kandidatët, jo vetëm për zotin {...} dhe zonjën {...}.

Klodian Kurushi: Pikërisht. Atëherë, edhe unë ndaj këtë qëndrim, domethënë që mund të mos jetë në të njëjtën datë, por të jenë në një datë të përafërt dhe të merren në shqyrtim të gjithë bashkë, do na krijonte më tepër lehtësi në procesin e vlerësimit që ne do bëjmë për relacionet që do paraqiten. Në këtë kuadër, duke na krijuar më tepër lehtësi,

pasi i shqyrtojmë në radhë të shpejtë, besoj se do jemi edhe afër të së vërtetës objektive. Kështu që unë jam dakord me propozimin që bëri zonja Shehu.

Naureda Llagami: Atëherë, unë jam kundër. Në fakt jam kundër, sepse Këshilli ka treguar që ka standarde si në menaxhimin e vlerësimeve, ashtu edhe duke promovuar njerëzit me kualitetet më të mira, ku shembull është Gjykata e Lartë, shembull është Gjykata e Apelit, dhe nuk na ka ceduar puna edhe për pjesën e futjes së gjithë vlerësimeve në një ditë apo jo.

Këto janë perceptime dhe janë ndoshta situata që na vijnë nga sistemi, por këto nuk duhet të afektojnë menaxhimin dhe efiçencën e mbledhjes plenare të Këshillit.

Në parimin tim si Kryetare, duke qenë se jam përgjegjëse për rendin e ditës, ajo që jam munduar që të mbaj parasysh është shpërndarjen e drejtë të ngarkesës së punës (një), dhe kohën që secili Komision administron aktet. Nëse ne do fusim rregulla të tilla për situata të caktuara, qoftë Gjykata e Lartë, se për mua nuk më intereson vetëm Gjykata e Lartë, më interesojnë gjykatat e apelit, atëherë do kemi një bllokim të situatës dhe të punës, efiçencës së evadimit të çështjeve që ka Këshilli dhe juve e kuptoni shumë mirë që në këto momente kemi ngarkesë shumë të madhe (ku përfshihen 45 kandidatët, ku përfshihet harta gjyqësore ku parashikohet të kemi pjesën e akteve nënligjore, ku përfshihet pjesa e verifikimit të kancelarëve që i kemi në proces), pra është e pamundur që neve të kemi luksin për të pasur situatën që neve t'i marrim dhe t'i fusim të gjitha gjërat në një ditë siç mendohet. Sot ne duhet të ecim me ritme të shpejta. Kështu që unë ftoj të gjithë Komisionet të kapim ritmin, të negociojmë edhe me institucionet që na i mbajnë peng shkresat, të marrim informacionet për të evaduar sa më shpejt. Kemi marrë një angazhim edhe ndaj raportimeve që bëjmë, që brenda dhjetorit ne duhet t'i mbyllim të gjithë proceset e vlerësimit dhe të caktimit në Gjykatë të Lartë. Kështu që nuk mendoj që kemi pjesë të menaxhimit të çështjes nga ana e Këshillit.

Atëherë, për çështjen e raportit të vlerësimit për znj. {...} do të shtyhet në seancë tjetër, ndërkohë ajo që është e propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është përcjellja e një akti i cili ka të bëjë me caktimin e një gjyqtari për gjykimin e çështjeve në një gjykatë në nevojë, siç është Gjykata e Apelit Vlorë. Ashtu siç është referuar nga Komisioni, është një akt me karakter urgjent, kështu që unë propozoj që këtë akt unë ta shtojë në rendin e ditës. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, shtohet akti në rendin e ditës.

Kështu që, pa humbur kohë fillojmë me aktet sipas rendit. Fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësve të cilët ne, në qoftë se ju rikujtohet, i kemi emëruar në mënyrë të përkohshme, për sa kohë ne duhet të bënim verifikimet e tyre. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Fatmira Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit Kryetare!

Një ndër përgjegjësitë që Kushtetuta i ka ngarkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor është dhe ajo lidhur me administrimin e administratës së gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja "d", dhe "ë" të saj, ku citohet: "1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: … d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata...".

Në Ligjin për Pushtetit Gjyqësor, i ndryshuar, në nenin 1, pika 1, shkronja "d" është parashikuar se një ndër qëllimet e tij kryesore është edhe përcaktimi i rregullave lidhur me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Edhe në nenin 50 e në vijim, deri në nenin 63 të këtij ligji, i dedikohet pikërisht statusit të nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatë. Në këto dispozita, lidhur me organin kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit është ngarkuar të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kjo kompetencë është e sanksionuar në nenin 59 të këtij ligji ku theksohet se: "1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.".

Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për ndihmës ligjor, ligji parashikon si të tilla, të njëjtat kritere të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimit civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kritere të veçanta për këtë kategori, kategorinë e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji ka parashikuar në pikën 2 të nenit 56 të Ligjit "Për pushtetin gjyqësor", i ndryshuar, disa kushte që janë: "2. Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin "Master shkencor", të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare".

Bazuar në këto kritere të mësipërme, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë pranë Këshillit dhe më pas vetë Këshilli me vendimin nr. 105, datë 05.07.2019, ka konstatuar faktin se të 6 kandidatët, konkretisht: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për të ndjekur Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019–2020, profili "ndihmës ligjor". Gjithashtu konstatohet se në përfundim të Shkollës së Magjistraturës me vendimin e saj nr. 30, datë 22.09.2020, "Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2019 – 2020", ka bërë renditjen e kandidatëve fitues.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me disa vendimmarrje të tij, mbështetur ndër të tjera në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në vendimin nr. 497, datë 21.10.2020, "Për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë e figurës të kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor që kishin kaluar me sukses Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për këshilltar dhe ndihmës ligjorë, vitin akademik 2019 - 2020" si dhe në vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor", si dhe mbasi ka konsideruar gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës, ka vendosur për të 6 kandidatët fitues si më poshtë:

1. Për znj. {...} - Paraprakisht me vendimin nr. 612, datë 10.12.2020 ka vendosur emërimin e përkohshëm në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Kurse me vendimin nr. 377, datë 14.09.2021 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, të znj.{...}, e cila ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019 – 2020.

2. Znj. {...} - Paraprakisht me vendimin nr. 613, datë 10.12.2020 ka vendosur emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Dhe me vendimin më pas nr.379, datë 14.09.2021 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, të znj. {...}, e cila ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019 – 2020.

3. Znj. {...} - Paraprakisht me vendimin nr. 611/2020 ka vendosur emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Kurse me vendimin nr. 235/2022 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, të znj. {...}, e cila ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019 – 2020.

4. Znj. {...} - Paraprakisht me vendimin nr. 615/2020 ka vendosur emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Dhe me vendimin nr.375/2021 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, të znj. {...}, e cila ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019 – 2020.

5. Z. {...} - Paraprakisht me vendimin nr. 616/2020 ka vendosur emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Kurse me vendimin nr. 378/2021 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së

emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, të z. Loci, i cili ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019 – 2020.

6. E fundit, znj. {...} - Paraprakisht me vendimin nr. 614/2020 ka vendosur emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Dhe me vendimin nr.374/2021 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, të znj. {...}, e cila ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019 – 2020.

Për shkak se të 6 kandidatët e mësipërm janë duke ushtruar detyrën e tyre pranë Njësive të Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe Tiranë dhe kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara në ligj, Këshilli ka detyrimin të bëjë pranimin në shërbimin civil gjyqësor të tyre në këto pozicione.

Nga gjithë sa më sipër, duke konstatuar se të 6 kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të ligjit, ata kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe janë kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, vlerësohet të pranohen në shërbimin civil për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit.

Në këto kushte, i propozohet Këshillit miratimi i 6 projektvendimeve, të cilat titullohen:

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë";

"Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit

ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë".

Struktura e projektvendimit parashikon:

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet pranimi në shërbimin civil gjyqësor i secilit prej kandidatëve në pozicionin e ndihmësit ligjor.

Në pikën 2 parashikohen efektet e juridike të këtij vendimi, të cilat fillojnë menjëherë me hyrjen në fuqi të vendimit.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet që një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet kandidatit në përputhje të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 4 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit kundër vendimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Në fund parashikohet se hyrja në fuqi e tij është në mënyrë të menjëhershme dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi redaktohet për sigurimin e anonimatit. Aktet janë veç e veç pastaj për miratim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

I kalojmë një nga një pasi janë akte të veçanta.

Kalojmë me aktin e parë që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Jeni dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i radhës që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} ({...}) për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e

Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord me projekt-aktin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pikat 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli.)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli.)

Naureda Llagami: Kalojmë në projektaktin e radhës që edhe ky ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të zonjës {...} në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar. Për më shumë detaje prapë ia jap fjalën zonjës Luli.

Fatmira Luli: Edhe zonja {...} ka mbaruar programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2021-2022 pasi ishte verifikuar më parë nga Këshilli me vendimin e tij nr.544 që plotësonte kushtet për të ndjekur programin fillestar. Kandidatja ka përfunduar me sukses programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2021-2022.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 27.07.2022, Shkolla ka përcjellë vendimin e saj me nr. 26, datë 27.07.2022, "Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për këshilltarë e

ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar", ku është vendosur edhe miratimi i listës së kandidatëve që sipas pikëve znj. {...} ka marrë 75.58 pikë dhe ka qenë kandidate e vetme e renditur në listën e kandidatëve për ndihmës ligjor.

Më pas me vendimin nr. 381, datë 19.09.2022, të KLGJ-së është vendosur kualifikimi për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor pranë gjykatës së apelit.

Konstatohet se znj. {...} ka paraqitur pranë KLGJ-së, kërkesën e regjistruar me nr. {...} prot., datë 26.09.2022, në të cilën shpreh interesin për emërim si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kushteve të saj shëndetësorë. Konkretisht, ajo parashtron se: "… Duke qenë se jam e diagnostikuar me një sëmundje/patologji e cila pamundëson një lëvizje motorike normale, më duhet të eci me një patericë dhe lëvizja në shkallë është shumë e vështirë për mua. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ofron një infrastrukturë (ashensor) e cila më lehtëson së tepërmi aksesin në punë, lutemi të më ndihmoni me emërimin pranë kësaj gjykate, pasi në një ambient tjetër aksesi në punë do të ishte shumë i vështirë…".

Referuar dispozitave të Kodit të Punës në pikat 8, 9, 10 të nenit 9 "Ndalimi i diskriminimit" parashikohet se: "8. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar...", dhe dispozitat ligjore përkatëse të ligjit të posaçëm, ku punësimi i personave me aftësi të kufizuar është rregulluar gjithashtu nga ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, i cili konkretisht i referohet detyrimit për trajtim të barabartë mes personave me aftësi të kufizuar me ata te aftë për punë. Për të mos u ndalur më shumë në detaje të dizpozitave të këtyre ligjeve të posaçme.

Duke qenë se kandidatja ishte kandidate e vetme dhe nuk kishte kandidatë të tjerë për të cilët të shpalleshin vendet e punës dhe duke pasur parasysh edhe kërkesën e saj për kushtet shëndetësore të posaçme dhe interesi i saj për t'u punësuar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit e cila ofron infrastrukturë, pas verifikimit të pasurisë është propozuar emërimi i saj i përkohshëm në këtë gjykatë apeli.

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit miratimi i projektvendimit, të titulluar:

"Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar”.

Është propozuar emërimi i përkohshëm për shkak se sipas ligjit, procedura e emërimit të tërë personelit në gjykatën e apelit i nënshtrohet verifikimit të posaçëm nga komisioni që ngrihet nga Gjykata e Posaçme, dhe për këtë shkak deri në përfundim të këtij verifikimi zonja {...} do ketë emërim të përkohshëm në pozicionin e ndihmëses ligjore dhe nuk do marri emërim përfundimtar për pranimin në shërbimin civil ashtu sikundër edhe dy ndihmësit e emëruar më parë pranë kësaj gjykate vazhdojnë akoma të mbajnë emërimin e përkohshëm sepse komisioni i posaçëm pranë kësaj gjykate nuk është ngritur akoma për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë dhe të pasurisë sipas ligjit.

Për këtë shkak propozohet struktura e projektvendimit si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet emërimi i përkohshëm në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundim të verifikimit shtesë të pasurisë dhe figurës nga ana e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës pranë kësaj gjykate.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohen efektet e juridike dhe financiare të këtij vendimi, të cilat fillojnë menjëherë me hyrjen në fuqi të tij.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet që një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe gjykatës ku është emëruar.

Në pikën 4 parashikohet e drejta e ankimit kundër vendimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në fund hyrja në fuqi e aktit në mënyrë të menjëhershme dhe që botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit. Faleminderit! Akti përkatës bashkëlidhur këtij relatimi që bëra më sipër.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundim të verifikimit shtesë të pasurisë dhe figurës nga ana e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, pranë kësaj gjykate.

2. Efektet juridike dhe financiare të këtij vendimi fillojnë me hyrjen në fuqi të tij.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pikat 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e planit të komunikimit për sistemin gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan***

Hallunaj.

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e planit të komunikimit për sistemin gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili në fakt për Komisionin tonë është shumë i rëndësishëm (Komisioni i Administrimit të Buxhetit). Dëshiroj që të falënderoj anëtaren për median, të caktuar nga Këshilli, lidhur me punën që ka bërë në propozimin që i ka bërë Komisionit të këtij akti dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi me këtë akt plotësohet komplet kuadri i akteve nënligjore që kemi lidhur me komunikimin që Këshilli dhe gjyqësori duhet të ketë me median. Kështu që unë ia jap fjalën koleges Shehu duke e përgëzuar edhe për punën që ka bërë për propozimin e projekt-akteve.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Faleminderit edhe për fjalën e rastit dhe për përgëzimet konkrete.

Unë gjithashtu do doja të përgëzoja në fakt të gjithë Komisionin i cili ka kontribuuar në hartimin e aktit. Do doja në mënyrë të veçantë të falënderoja Qendrën ALTRI dhe projektin e zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje dhe Perëndim i cili ofron mbështetje teknike për KLGJ-në, dy partnerë këta që kanë asistuar dhe kanë dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në hartimin e planit të komunikimit për gjykatat, si

një dokument shumë i rëndësishëm i cili do të lehtësojë komunikimin e gjykatës me publikun duke rritur kështu edhe transparencën. Do doja të falënderoja në fakt edhe zotin Erjon Muharremaj, ish-anëtarin e Këshillit dhe ish-anëtar i Këshillit i caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhënien me publikun dhe median, i cili më herët kishte nisur punën për hartimin e këtij plani dhe më pas u finalizua nga partnerët, nga unë dhe nga Komisioni i Administrimit dhe Buxhetit.

Pa ju lodhur më shumë unë do doja të bëja një parashtrim/paraqitje të shkurtër të asaj që përmban Plani i Komunikimit për gjykatat.

Nevoja për hartimin e këtij vendimi vjen në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 91 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë," ku parashikohet se KLGJ-ja është përgjegjëse për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun dhe median.

Lidhur me natyrën e aktit dhe harmonizimin e tij me kuadrin ligjor ekzistues:

Akti që i paraqitet për miratim Këshillit është një akt nënligjor, i cili është i harmonizuar me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor, objektivin strategjik 5 të Planit Strategjik të KLGJ-së, si dhe parimet mbi të cilat është hartuar edhe Strategjia e Komunikimit për Sistemin Gjyqësor e KLGJ-në, e më konkretisht transparenca, profesionalizmi, ndershmëria, llogaridhënia dhe drejtësia.

Lidhur me përputhshmërinë e aktit me standardet ndërkombëtare:

Standardet dhe parimet ndërkombëtarë që kanë udhëhequr hartimin e këtij Plani Komunikimi janë të shumta. Akti reflekton praktikat më të mira ndërkombëtare, e veçanërisht:

- Rekomandimet e Opinionit 7 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë "Drejtësia dhe shoqëria", ku vendoset theksi në disa nga parimet e Planit të Veprimit të Kuadrit Global për Gjyqtarët, e më konkretisht:

Roli edukues i gjykatave në një demokraci, ku marrëdhëniet e tyre me median dhe publikun i shërbejnë forcimit të besimit tek gjyqësori;

Aksesi, thjeshtësimi dhe qartësia e gjuhës së përdorur nga gjykatat në procese dhe vendime.

Akti reflekton praktikat më të mira ku përmendim:

- Rekomandimet (Rec) 13 (2003) të 10 korrikut 2003 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Për sigurimin e informacionit përmes mediave lidhur me

procedimet penale"; Parimet 1-19;

- Rekomandimet (Rec) 12 (2010) e datës 17 nëntor 2010 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Për çështjet e pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së gjyqtarëve" - të cilat janë në interesin publik, paragrafi 19, i cili parashikon çështjet që lidhen me "trajtimin i administrimit të drejtësisë që janë me interes publik…. Gjyqtarët duhet të ushtrojnë vetëpërmbajtje në marrëdhëniet e tyre me median";

- Magna Karta e Gjyqtarëve, e miratuar më 17 nëntor 2010 nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) në paragrafin 14 (Qasja në drejtësi dhe transparencë) parashikon se "Drejtësia duhet të jetë transparente dhe informacioni mbi funksionin e sistemit gjyqësor duhet të publikohet."

- Paragrafin 19 të Rekomandimit 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare, në temën e pavarësisë, efektivitetit dhe përgjegjësia e gjyqtarëve, miratuar më 17 nëntor 2010: "Procedurat dhe çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë janë me interes publik. Megjithatë, e drejta për informim në lidhje me çështjet gjyqësore duhet të ushtrohet duke pasur parasysh kufizimet e imponuara nga pavarësia e gjyqësorit. Zëdhënësit e gjykatave ose themelimi i shërbimeve të shtypit dhe të komunikimit janë në përgjegjësinë e gjykatave ose nën këshillat gjyqësorë apo nën autoritete të tjera të pavarura është i inkurajuar. Gjyqtarët duhet të jenë të përmbajtur në marrëdhëniet e tyre me mediat.".

- Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ), në raportin "Besimi publik dhe imazhi i drejtësisë - Raporti 2017-2018", miratuar në Lisbonë më 1 qershor 2018, nxori rekomandimet mbi hartimin e strategjive alternative të komunikimit, pasi duke u fokusuar në rëndësinë e komunikimit të gjyqësorit dhe rritjen e besimit të publikut tek drejtësia, vëzhgoi se komunikimi i efektshëm i sistemit gjyqësor krijon mundësinë për këtë sistem që të shpjegojë rolin dhe veprimtarinë e tij, duke zhvilluar në këtë mënyrë besimin dhe mirëkuptimin që ai (sistemi gjyqësor) është i paanshëm dhe i drejtë. Gjithashtu raporti thekson se strategjia e komunikimit për pushtetin gjyqësor nuk duhet të jetë vetëm informative, por duhet të jetë edukuese dhe t`i përgjigjet nevojave të publikut.

Po ashtu, akti merr parasysh praktikat më të mira të krijuara nga zbatimi i modeleve ekzistuese të planeve të komunikimit të gjykatave në rajon, nivel evropian e më gjerë. Këto praktika konfirmojnë nevojën për një qasje standarde të komunikimit proaktiv

nga ana e gjykatave,

Lidhur me konsultimin e aktit:

Plani i Komunikimit është produkt i bashkëpunimit të ngushtë me Qendrën ALTRI dhe me Projektin e zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim, i cili ofron mbështetje teknike për KLGJ-në në përmbushjen e objektivave strategjikë. Drafti i Planit të Komunikimit iu është dërguar për konsultim të gjithë gjykatave, gjyqtarëve të medias dhe njësisë përgjegjëse pranë KLGJ-së si dhe i është nënshtruar procesit të konsultimit me organizata të shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Komente të përgjithshme mbi aktin:

Plani i komunikimit dyvjeçar të gjykatave është një pikënisje për të strukturuar mënyrën sesi ato i përqasen publikut dhe aktorëve të tjerë të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi dhe ka si qëllim të mbështesë zbatimin e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor.

Plani i Komunikimit shoqërohet me një Plan Veprimi duke dhënë ide dhe mjete praktike për ta bërë komunikimin më të lehtë, më të kuptueshëm dhe me sa më shumë ndikim në drejtim të rritjes së transparencës, nivelit të informimit, cilësisë së shërbimeve, profesionalizmit dhe për rrjedhojë, besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Ai përcakton përparësitë e komunikimit, objektivat, grupet e synuara, mesazhet kryesore dhe mjetet e nevojshme të komunikimit

Plani i komunikimit ofron zgjidhje novatore dhe qasjet më të mira për të komunikuar në mënyrë efektive duke shfrytëzuar të gjithë mjetet e komunikimit që mundëson teknologjia. Ai do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të zhvillimeve për t'u përshtatur me situata apo prioritete që mund të paraqiten në të ardhmen dhe i takon të gjithë aktorëve që ta jetësojnë atë.

Qëllimi i çdo plani komunikimi është ta bëjë informacionin të arritshëm dhe të kuptueshëm për çdo audiencë të gjykatës, përfshi këtu: publikun, përdoruesit e gjykatave, median, degët e tjera të qeverisjes, partnerët ndërkombëtarë, gjyqtarët apo edhe personelin e gjykatave. Progresi i shpejtë i teknologjisë dhe kanaleve të komunikimit shtron si domosdoshmëri nevojën për komunikim efektiv nga ana e gjykatave me grupet e interesit. Ky komunikim duhet të jetë i qëndrueshëm, por edhe i programuar në kohë dhe buxhet. Komunikimi është efektiv kur gjykata arrin të kuptojë nevojat e çdo grupi interesi, iu ofron informacionin që u nevojitet, rrit ndërgjegjësimin mbi gjykatat dhe

proceset gjyqësore, iu kërkon atyre opinione për përmirësim dhe investon në disa kanale komunikimi me qëllim ofrimin e të njëjtit mesazh. Sot Facebook, YouTube, Twitter, Linkedin, etj., janë duke transformuar mënyrën sesi njerëzit kërkojnë informacionin apo kuptojnë zhvillimet në botë. Këto mjete komunikimi janë mundësi për gjykatat për të promovuar hapjen maksimale dhe përgjegjshmërinë, të inkurajojnë komunikimin ndërmjet gjykatave, gazetarëve dhe qytetarëve. Për më tepër, ato prezantojnë mundësi për gjykatat që të dëgjojnë shqetësimet publike dhe duhet të bëjnë përpjekje për të plotësuar pritshmëritë në ndryshim të çdo audience, për t'i edukuar ato, të sigurojë transparencë në administrimin e gjykatave, duke rritur besimin e publikut.

Nismat e gjykatave që kanë fokus komunikimin dhe ndërveprimin me publikun, median dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile mbetet në nivele të ulëta. Numri i ulët i aktiviteteve të zhvilluara me publikun, median dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, për shkak edhe të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, numri i ulët i daljeve publike të gjyqtarit për median apo nëpunësit për marrëdhëniet me median dhe publikun, dhe sasia e kufizuar e materialeve informuese të publikuara nga gjykatat, dëshmojnë për nevojën emergjente për komunikim me publikun.

Në kuadër të hartës së re gjyqësore, ky plan komunikimi është një mundësi më shumë që gjykatat të orientojnë veprimtarinë e tyre në funksion të komunikimit dhe rritjes së informimit të publikut dhe medias lidhur me këtë riorganizim të kompetencave territoriale të tyre. Për më tepër, hartimi i këtij plani komunikimit vjen në kohën e duhur duke i shërbyer gjykatave për ta komunikuar në mënyrë të strukturuar dhe mirë menduar këtë proces si dhe për të mundësuar edukimin e duhur ligjor të publikut.

Do të paraqesim një shpjegim pak më në detaje të përmbajtjes së aktit.

Plani i komunikimit të gjykatave është rrjedhojë e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, e në këtë kuptim, qëllimi dhe objektivat e këtij plani janë në përputhje me synimet dhe objektivat strategjike që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për sistemin gjyqësor.

Qëllimi kryesor - Rritja e besimit të publikut dhe e transparencës në sistemin gjyqësor nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe mënyrave novatore të komunikimit dhe informimit midis gjykatës me median dhe publikun.

Në mënyrë që qëllimi kryesor të arrihet, gjashtë objektiva kryesorë strategjikë janë parashikuar:

Objektivi nr. 1: Informimi i publikut dhe promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i Reformës në Drejtësi;

Objektivi Nr. 2: Identifikimi, promovimi, informimi dhe rritja e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit si mjete novatore të komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë mes palëve të interesit dhe gjykatave;

Objektivi Nr. 3: Informimi i publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave dhe mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës;

Objektivi Nr. 4: Informimi i publikut, veçanërisht grupeve në nevojë dhe të miturve, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifat gjyqësore;

Objektivi Nr. 5: Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, Organizatave të shoqërisë civile, palëve të tjera të interesit;

Objektivi Nr. 6: Afrimi i komunitetit me Gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjësuese që kulmojnë në javën e drejtësisë.

Plani i Komunikimit ndjek një strukturë të unifikuar për secilin objektiv, ku evidentohet grupi i interesit të cilin synon të arrijë ky objektiv, institucionet përgjegjëse dhe kanalet e komunikimit. Veprimet janë të detajuara në hapa konkretë, shoqëruar me mesazhet konkrete, indikatorët e përmbushjes së objektivit dhe njësitë matëse.

Plani i Komunikimit shoqërohet nga plani i veprimit që përmban afate konkrete të zbatimit të tij, si dhe nga disa shtojca të cilat janë modele aktesh dhe materiale orientuese që lehtësojnë përmbushjen e objektivave.

Lidhur me zbatimin e aktit:

Suksesi i këtij Plani Komunikimi ndërvaret nga zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i planeve të tij të veprimit. Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të këtyre planeve të veprimit, secila gjykatë do të përcaktojë punonjësin përgjegjës (pikën e kontaktit) për këtë qëllim, i cili mund të jetë gjyqtari, nëpunësi për marrëdhënien me median dhe publikun, koordinatori i të drejtës së informimit ose çdo person tjetër i përcaktuar prej tyre me funksionet e marrëdhënies me median dhe publikun. Punonjësit përgjegjës të përcaktuar nga secila gjykatë, do të organizohen në formën e një grupi pune, i cili do të koordinohet dhe udhëhiqet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim organizimin e punëve në kuadër të këtij plani, shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve dhe prodhimit të materialeve informuese mes gjykatave, si dhe sigurimin e një lidhjeje harmonike të këtij Plani Komunikimi me politikat strategjike që ka Këshilli për sa i përket

komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.

Punonjësi i përcaktuar i secilës gjykatë për zbatimin dhe monitorimin e Planit të Komunikimit do të hartojë raportin 3 dhe 6-mujor dhe atë vjetor të realizimit dhe ecurisë së planit, i cili do t'i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor. KLGJ-ja do të hartojë dhe miratojë një format të unifikuar të raportit. Monitorimi do të mbështetet në progresin e zbatimit të çdo aktiviteti të parashikuar në planin e veprimit duke ndjekur rregullisht zbatimin e aktiviteteve sipas përshkrimit, afatin e realizimit të tyre dhe përmbushjen e indikatorëve të parashikuar. Qëllimi i këtij monitorimi është adaptimi/përmirësimi i planit në varësi të kushteve, rrethanave apo nevojave që gjykatave mund t'i lindin gjatë kohës së zbatimit të tij. Gjykatat në raportin e monitorimit të realizimit të planit do të paraqesin edhe vështirësitë dhe rekomandimet për përmirësim apo rishikim.

Vlerësimi i ndikimit të Planit të Komunikimit, gjatë zbatimit të tij do të mbështetet në indikatorët e performancës dhe të impaktit të parashikuar për çdo objektiv. Indikatorët mund të përditësohen në vijimësi në varësi të zhvillimeve që mund të ndodhin në sistemin gjyqësor.

Zbatimi i aktit kërkon qasje proaktive nga të gjitha gjykatat, veçanërisht gjyqtarët e medias dhe nëpunësit përgjegjës të cilët do të caktohen në Grupin e Punës për të bashkëpunuar ngushtësisht me KLGJ-në për arritjen e objektivave.

Lidhur me efektet financiare të aktit:

Plani i Komunikimit nuk krijon efekte financiare shtesë për vitin 2022, megjithatë KLGJ-ja mbetet e angazhuar për të përfshirë në proceset e rishikimit të buxhetit të sistemit të drejtësisë aktivitetet konkrete, për të siguruar mbështetjen e duhur financiare për përmbushjen e objektivave. Plani i Komunikimit synon të vihet në zbatim edhe nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, të cilët do të ofrojnë edhe ekspertizën për të krijuar një praktikë të konsoliduar të zbatimit të tij. Disa prej tyre, aktualisht, kanë shprehur vullnetin për të bashkëpunuar me Këshillin, në lidhje me disa prej aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit, duke u angazhuar konkretisht edhe në mbështetjen financiare të realizimit të këtyre aktiviteteve që do të ishte lehtësi për Këshillin dhe për gjykatat.

Ky është relacioni që shoqëron projektvendimin i cili i paraqitet për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare i titulluar Projektvendim "Për miratimin e planit të komunikimit për gjykatat".

Në pikën 1 parashikohet miratimi i Planit të Komunikimit për gjykatat në Republikën e Shqipërisë dhe shtojcave bashkëngjitur si pjesë integrale e tij.

Në pikën 2 parashikohet që Këshillat e Gjykatave, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, caktojnë pikën e kontaktit (gjyqtarin për mediat, nëpunësi për marrëdhënien me median dhe publikun/koordinatori i të drejtës së informimit ose çdo person tjetër i përcaktuar prej tyre me funksionet e marrëdhënies me median dhe publikun), për monitorimin dhe zbatimin e këtij Plani Komunikimi.

Pika e kontaktit, raporton çdo 3 muaj pranë Drejtorisë për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për zbatimin e Planit të Komunikimit, sipas formatit të raportimit, shtojcë e Planit të Komunikimit.

Gjithashtu në pikën 4 parashikohet që anëtari përgjegjës për marrëdhënien me median me publikun, raporton pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, një herë në vit për zbatimin e këtij Plani Komunikimi.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, unë do ftoja kolegët.

Po!

Brikena Ukperaj: Duke përgëzuar edhe unë Komisionin, por mos të vazhdoj më tej sepse është një punë shumë voluminoze dhe shumë profesionale, e kam diskutimin vetëm në lidhje me hyrjen në fuqi të vendimit. Akti në fakt ka një karakter normativ. Si e keni konceptuar?

Domethënë është kolektiv, është normativ? Cila është natyra e aktit pak a shumë?

Si do ta konsiderojmë sepse është një plan komunikimi për të gjitha gjykatat dhe është me karakter nënligjor. Nëse është akt normativ duhet ta botojmë në Fletoren Zyrtare. Nëse do ta konsiderojmë një akt kolektiv, ai do të hyjë në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit. Po sigurisht që akt individual nuk është.

Marçela Shehu: Akt individual nuk është. Në fakt është akt kolektiv në vlerësimin tim, si Plani Strategjik.

Brikena Ukperaj: Si Plani Strategjik. Atëherë do të hyjë në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit.

Naureda Llagami: Pra jo "menjëherë".

Marçela Shehu: Sepse aktorët e tjerë ndërveprojnë, por Plani i Komunikimit dhe Plani i Veprimit në fakt i adresohet dhe i drejtohet gjykatave dhe personave përgjegjës që lidhen me gjykatën.

Brikena Ukperaj: Pra vetëm këtë saktësim kemi.

Naureda Llagami: Okej! Me gjithë saktësimin që bëri Brikena, kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Merr fjalën zoti Toro:

Alban Toro: Në vijim të gjithë këtyre përgëzimeve modeste që dëgjova, natyrisht na përket që edhe ne të përgëzojmë grupin e punës që për formën dhe mënyrën që i kanë dhënë aktit dhe kanë ditur që transparencën e heshtur të Këshillit, duke i dhënë formë dhe përmbajtje, e kanë transferuar në gjykata. Ju lumtë!

Naureda Llagami: Kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e Planit të Komunikimit për gjykatat në Republikën e Shqipërisë dhe shtojcave bashkëngjitur si pjesë integrale e tij.

2. Këshillat e Gjykatave, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, caktojnë pikën e kontaktit (gjyqtarin për mediat, nëpunësi për marrëdhënien me median dhe publikun/koordinatori i të drejtës së informimit ose çdo person tjetër i përcaktuar prej tyre me funksionet e marrëdhënies me median dhe publikun), për monitorimin dhe zbatimin e këtij Plani Komunikimi.

3. Pika e kontaktit, raporton çdo 3 muaj pranë Drejtorisë për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për zbatimin e Planit të Komunikimit, sipas formatit të raportimit, shtojcë e Planit të Komunikimit.

4. Anëtari përgjegjës për marrëdhënien me median me publikun, raporton pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, një herë në vit për zbatimin e këtij Plani Komunikimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pikat 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të zonjës {...}"", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator znj. Marçela Shehu e kam këtu.

Do e bësh ti? (i drejtohet zotit Kurushi)

Zoti Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Pa humbur kohë po vijoj relacionin që ka për objekt projektvendimin "Për shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të zonjës {...}"".

Me vendimin nr. 259, datë 23.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: "1.Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga znj. {...}, për rikthimin e saj në

funksionin e Këshilltarit të Gjykatës së Lartë për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë... ”

Ky vendim erdhi si pasojë e vlerësimit të faktit se kërkimi përpara Këshillit ishte për shqyrtim edhe përpara gjykatës. Pra, ky vendim i ndërmjetëm u konkludua duke mbajtur në konsideratë parashikimin procedural civil, sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile gjyqësore që është duke u gjykuar nga gjykata.

Këshillit të Lartë Gjyqësor i është komunikuar vendimi nr. {...}, datë 23.06.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit me palë paditëse znj. {...} dhe palë të paditura Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e sipërcituar ka vendosur:

“1. Ndryshimin e vendimit nr.{...}, datë 07.06.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Pranimin e padisë.

3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr.{...}, datë 06.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

4. Kthimin në detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë të paditëses {...}.

5. Detyrimin e palës së paditur Gjykata e Lartë për pagimin e pagës për periudhën 14.10.2017 deri në ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor.

6. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.

7. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga shërbimi përmbarimor.

Njëkohësisht është dhënë edhe e drejta e ankimit brenda 30 ditëve në kolegjin administrativ të Gjykatës së Lartë.

Znj. {...} në vijim të kërkesave të mëparshme drejtuar Këshillit, me kërkesën nr.{...} prot., datë 07.09.2022 i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor duke kërkuar ekzekutimin e vendimit nr. {...}, datë 23.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Vlerësimi i Komisionit

Pra kemi një vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka vendosur Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga znj. {...}, për rikthimin e saj në funksionin e Këshilltarit Ligjor për shkak se kërkesa është në shqyrtim në gjykatë.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është një vendim i formës së prerë

dhe përbën titull ekzekutiv.

Në këto rrethana Këshillit i duhet që të disponojë lidhur me shfuqizimin e vendimit të pezullimit të shqyrtimit të kërkesës nga znj. {...} për rikthimin e saj si Këshilltare Ligjore në Gjykatën e Lartë.

Ky disponim vendoset kryesisht nga Këshilli në përputhje me nenin 68/2 të Kodit të Procedurave Administrative pasi është rasti për shfuqizimin e vendimit nr.273, datë 20.07.2022. në kushtet kur shkaqet e ekzistencës së tij kanë pushuar së ekzistuari.

Me qëllim për t'i garantuar palës kërkuese një proces të rregullt në këtë procedurë administrative, ky vendim do t'i njoftohet palës së interesuar znj. {...}.

Struktura e projektvendimit.

Në pikën e parë të projektvendimit parashikohet shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}."

Në pikën e dytë të projektvendimit parashikohet vijimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}.

Në pikën e tretë parashikohet se një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet personit të interesuar.

Në pikën e katërt parashikohet se kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Atëherë, lidhur me projektvendimin që ne kemi dërguar për miratim, propozojmë që pika 2 e këtij projektvendimi, pra "Vijimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}", të hiqet për sa kohë ajo është pjesë e relacionit dhe është pjesë e pasojave që lindin ligjërisht nga shfuqizimi i vendimit të pezullimit të një akti administrativ.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord me gjithë propozimin e bërë nga relatori?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord. *(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, e vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së saj i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}."

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet znj. {...}.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pikat 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}", (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan***

Hallunaj.

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}", (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit për periudhën 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}.

Kështu që, për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Zoti {...}, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës është konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Dosja është përcjellë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe menjëherë ka filluar procedura e gradimit të gjyqtarit me vendimin nr. 22 të datës 17.01.2022. Në përfundim të procedurës, projektraporti i vlerësimit i është komunikuar gjyqtarit në adresën e tij elektronike. Gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e tij me shkrim. Nuk ka paraqitur prova të reja për arsye sepse kundërshtimet e gjyqtarit i referohen vetëm dy treguesve të aftësive të tij profesionale, konkretisht: "Aftësisë për të interpretuar ligjin" si dhe komponentit të "Analizës dhe argumentimit logjik", dhe nuk ka paraqitur prova të reja. Pra ka bërë objeksionet e veta mbi të njëjtat akte që relatori ka

shqyrtuar paraprakisht. Gjyqtari nuk ka kërkuar të paraqitet për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Projektraporti i vlerësimit i është njoftuar paraprakisht anëtarëve dhe është voluminoz, po kështu edhe materialet e dosjes së vlerësimit gjithashtu, kështu që unë do ndalem në elementë të caktuar të rëndësishëm që lidhen me burimet e vlerësimit si dhe në propozimet lidhur me secilin nga treguesit e katër kritereve të vlerësimit, duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek treguesit për të cilët gjyqtari ka paraqitur edhe kundërshtimet e tij.

Projektraporti i vlerësimit fillon me paraqitjen e elementëve të rëndësishëm të procedurës së tij. Në vijim pasqyrohen burimet e vlerësimit dhe evidentimit të të dhënave që rezultojnë prej tyre. Burimet e vlerësimit janë të ndara në dy grupe. Grupi i parë janë

aktet dhe dokumentet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit të listuara, midis të cilave janë edhe të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short, bashkë me tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari. Në këto materiale ka edhe vendime të administruara nga organet e rivlerësimit kryesisht ose për shkak të ankesave që i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Në dosjen e vlerësimit të dërguar nga organet e rivlerësimit rezultojnë të jenë administruar disa vendime, brenda dhe jashtë periudhës së rivlerësimit, në kuadër të trajtimit të ankesave dhe denoncimeve nga publiku.

Lidhur me çështjet e administruara për shkak të indicieve, referuar vendimit nr. 394, datë 07.06.2021 të KPK-së, rezulton se për gjyqtarin {...}, janë verifikuar 4 (katër) çështje, ndërkohë që në dosje rezulton që aktet janë administruar vetëm për 1 (një) prej tyre. Konkretisht janë administruar:

Aktet e çështjes civile me palët paditëse përkatëse ku elementët përkatës të padisë (objekti dhe palët) janë pasqyruar edhe në projektvendim. Në këtë çështje gjyqtari ka pasur cilësinë e anëtarit. KPK ka konstatuar se: " ...trupa gjykuese e Gjykatës së Apelit Durrës, anëtar i së cilës ka qenë edhe gjyqtari {...}, nuk ka verifikuar dhe më pas nuk ka korrigjuar gabimet procedurale në vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në zbatim të dispozitave përkatëse të K.Pr.Civile, si gjykatë më e lartë (e gjeni në faqen 9 të projektraportit këtë konstatim), si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pikave të ankimit të të paditurës, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016,

nga organet e vlerësimit është përcjellë kjo dosje për inspektim pranë ILD-së me qëllim verifikimin e shkeljeve të mundshme disiplinore nga ana e gjyqtarit z. {...}.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka trajtuar çështjen e përcjellë nga KPK dhe me vendimin nr. {...} prot., datë 18.05.2022, ka vendosur "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit". Referuar përmbajtjes së vendimit rezulton se ankesa është arkivuar për shkak të parashkrimit, pra sepse faktet gjyqësore që janë referuar nga KPK-ja kanë qenë tej afatit të parashkrimit për shkeljet disiplinore nga ana e magjistratëve dhe në këto kushte ajo nuk përmbushte një ndër kriteret e pranueshmërisë për trajtim.

Materiali në fakt i referuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga organet e rivlerësimit kalimtar i përket një çështjeje civile e cila ka përfunduar me vendimin e datës 26.07.2016 të Gjykatës së Apelit Durrës, në të cilin gjyqtari {...} ka qenë në cilësinë e anëtarit (pra nuk ka qenë relator i çështjes). Në zbatim të nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin, procesi i gradimit që Këshilli duhet të fillojë me përparësi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, përfshin çdo dokument të përdorur nga organet e rivlerësimit për vlerësimin e aftësive profesionale. Vendimi gjyqësor duke qenë se dhënë në vitin 2016 bën pjesë në periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe si i tillë ai përbën burim vlerësimi për efekt të procesit të gradimit. Pavarësisht "arkivimit për shkak parashkrimi" nga organi disiplinor, ky vendim gjyqësor në kushtet kur përbën burim vlerësimi për efekt gradimi është analizuar në drejtim të kriterit të parë që lidhet me aftësitë profesionale të gjyqtarit, për treguesin e "Aftësisë së gjyqtarin në interpretimin e ligjit procedural". Për kriterin e dytë të "Aftësive organizative" në kushtet kur gjyqtari nuk ka qenë relator i çështjes, dhe nga organet e rivlerësimit dhe ILD-ja nuk ka të dhëna që lidhen me menaxhimin e kohës nga ana e gjyqtarit, vendimi i mësipërm nuk përbën burim vlerësimi dhe as referohet nga institucionet përkatëse që duhet të analizohet në kuadër të produktivitetit dhe menaxhimin efektiv të kohës nga ana e gjyqtarit.

Nga hetimi administrativ është konstatuar se nga Gjykata e Apelit Durrës nuk ishin analizuar kundërshtimet e parashtruara nga pala paditëse dhe në relacion gjeni të pasqyruara të gjitha shkaqet për të cilat çështja ishte referuar. Në relacion gjithashtu gjenden edhe argumentimet që gjyqtari ka dhënë gjatë procedurës së rivlerësimit lidhur me këtë çështje sepse është pyetur gjerësisht dhe në mënyrë të hollësishme.

Nga ana ime si relatore, pasi i kam shqyrtuar elementët e vendimit që lidhen gjithmonë me kriterin e "Aftësive profesionale", kam konstatuar se shkaqet për të cilat çështja ishte referuar dhe transferuar në ILD për inspektim, në fakt lidheshin me mënyrën se si nga gjykata ishte interpretuar dhe zbatuar ligji procedural. Bëheshe fjalë për një çështje të pushuar dhe ishte çështja e vlerësimit të provave që kishte marrë gjykata e shkallës së parë në çështje të pushuara, duhet të rimerreshin apo jo. Si i tillë, ky vendim, kam vlerësuar që nuk afekton aftësitë profesionale të gjyqtarit në treguesin e "Aftësisë së gjyqtarit për të interpretuar ligjin" sepse sipas parimeve të vlerësimit vlerësuesi nuk mund të zëvendësojë logjikën e gjyqtarit dhe as mënyrën se si prej tij interpretohet në rastin konkret neni 300 i K.Pr.Civile apo neni 6 i K.Familjes që bënte fjalë për parimin e dëgjimit të të miturit.

Lidhur me denoncimet nga publiku, referuar vendimeve të administruara, në fakt ka vetëm një vendim të administruar nga 19 denoncime. Vendimi rezulton i vitit 2019 dhe si i tillë rezulton që të jetë dhënë jashtë periudhës së vlerësimit 2013-2016, si i tillë ai nuk përbën burim vlerësimi për efekt gradimi dhe nuk mund të merret në analizë nga ana e vlerësuesit për asnjë nga kriteret e vlerësimit, por është një e dhënë që duhet vlerësuar nga ana e Këshillit në vlerësimet periodike të gjyqtarit që përfshin periudhën kohore në të cilën referon fakti/vendimi konkret.

Lidhur me të dhënat burimore dhe arkivore të KLD-së, nga raporti analitik që ish-KLD ka përgatitur për organet e rivlerësimit ka rezultuar se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit "8 tetor 2013- 8 tetor 2016", për gjyqtarin {...} janë paraqitur gjithsej 5 ankesa (2 të vitit 2015, 3 të vitit 2016) në ish-Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 2 ankesa ishin bashkuar me ankesën bazë e cila ishte një ankesë për një tjetër trup gjykues, pra nuk lidhej me gjyqtarin {...}. 3 ankesa të vitit 2016 ishin verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë: - 2 ankesa janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe në përfundim është vendosur arkivimi pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarit {...}; - 1 ankesë e verifikuar për mosrespektim formal ligji është mbajtur në verifikim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Më pas, me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë ILD-së e cila e ka trajtuar kërkesën dhe do ta relatoj më vonë në projektraportin e vlerësimit.

Nuk ka asnjë të dhënë për kërkesa disiplinore të marra apo të zbatuara gjatë vitit 2013-2016.

Në raportin e vlerësimit gjenden të detajuara, janë marrë materialet e të gjitha ankesave të bëra ndaj gjyqtarit, të cilat ju i keni të gjitha të shpjeguara me rezultatet e verifikimit të tyre, dhe nuk ka të dhëna që mund të afektojnë vlerësimin etik dhe profesional sepse lidhen gjithmonë me elementë të shqyrtimit të shkaqeve që duhet të vlerësohen nga gjykata më të larta.

Për sa i përket një të dhëne, një ankesë e cila ishte mbajtur për verifikim, në fakt nga materialet që janë marrë nga ILD-ja na rezulton që për këtë çështje kishte filluar një hetim disiplinor ndaj disa gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe ndaj trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës, midis të cilësive edhe zotit {...}, i cili kishte shqyrtuar çështjen.

Konkretisht me urdhrin nr. {...}, datë 12.11.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ishte urdhëruar ngritja e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave të përcjella pranë KLGJ-së dhe pranë Zyrës së ILD-së, dhe me vendimin e datës 26.01.2018 ishte marrë pezullimi i hetimit disiplinor për disa gjyqtarë, midis të tjerëve edhe gjyqtarit {...}, duke qenë se bëhej fjalë për një çështje e cila ishte në gjykim në Gjykatën e Lartë. Pasi çështja ka përfunduar së gjykuari në Gjykatën e Lartë (ju të gjithë jeni në dijeni sepse nga zonja Shehu na është vënë në dispozicion vendimi për pushimin e hetimit të gjyqtarit {...}), pasi çështja është trajtuar nga Gjykata e Lartë e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit Durrës, nga ana e ILD-së është marrë vendimi për revokimin e vendimit të pezullimit dhe më tej është marrë vendim për pushimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit dhe gjyqtarëve të tjerë për shkak sepse çështja lidhej me interpretimin e ligjit material i cili nga Gjykata e Lartë ishte gjetur korrekt. Kështu që edhe në këtë drejtim, pasi janë administruar të gjitha të dhënat, nuk ka pasur të dhëna që mund të afektonin aftësinë e gjyqtarit si në kuadër të aftësive të tij profesionale, aftësive organizative apo edhe etikës dhe integritetit të tij në detyrë.

Këto janë disa të dhëna që doja t'i citoja për sa i përket burimeve. Pjesa e parë e burimeve përmban edhe të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të gjyqtarit. Pjesë e rëndësishme e burimit është edhe vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Grupi i dytë i burimeve përbëhet nga çështje të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit. Duke qenë se këto çështje prezantohen për herë të parë, atëherë në projektraport janë të evidentuara me saktësi e gjithë ecuria procedurale e këtyre çështjeve nga seanca e parë gjyqësore deri në momentin e shpalljes së vendimit,

duke parashikuar numrin e seancave, kohëzgjatjen e gjykimit, mënyrën e menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarit, mënyrën e strukturimit të vendimit gjyqësor si dhe mënyrën e administrimit të akteve në dosjen gjyqësore (janë për të gjitha çështjet).

Mbi bazën e këtyre burimeve, nga ana ime si relatore, pasi Komisioni ka vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit dhe plotësimit të dokumentacionit është përpiluar edhe projektraporti i vlerësimit.

Lidhur me vlerësimet dhe propozimet e mia si relatorë, për sa i përket kriterit të parë që ka të bëjë me "Aftësitë profesionale të gjyqtarit", aspekti i "Njohurive ligjore", treguesi "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave", në tërësi, nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit (i keni të ndara vendimet civile dhe penale) është konstatuar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe paraqitjen e tyre në mënyrë koncize, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin ose referimin e normave respektive në funksion të konkluzionit të tij mbi bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ankimit dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Për këtë tregues propozohet aftësi shumë e lartë e gjyqtarit duke u pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket "Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes", në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës, kryesisht asaj materiale - civile ose penale apo procedurale, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi. Por ajo që unë si relatore kam konstatuar, në shumicën e rasteve citimi nuk shoqërohet me një interpretim zbërthyes të elementëve dhe qëllimit të normës, për të shkuar si rrjedhë logjike me konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me mënyrën e zbatimin e saj, sepse bëhet fjalë për një vendim gjykate apeli. Interpretimi i pavarur i normës gjendet kryesisht në mënyrë pothuajse gjithpërfshirëse në çështjet civile dhe rrallë tek çështjet penale, ku kryesisht ndeshemi vetëm me citim të dispozitës. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teologjik të normës dhe duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit.

Lidhur me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm, në projektraport pasqyrohen të gjitha dispozitat e interpretuara si ato materiale, procedurale, në çështjet civile dhe në ato pak vendime që është gjetur interpretim në çështjet penale. Ndërkohë që

në vendimet e tjera burim vlerësimi ligji i zbatueshëm referohet dhe aplikohet direkt mbi faktin në mënyrë konkrete gjatë zbatimit të tij, por nuk ka një zbërthim paraprak në nivel teorik të normës e cila kushtëzohet jo gjithmonë nga natyra e thjeshtë e konfliktit/çështjes mbi të cilën zbatohet shkaqet e ankimit. Pra jo të gjitha konfliktet kanë qenë të thjeshta për të thënë që norma mund të aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ka pasur edhe konflikte ku në shkaqe ankimi është ngritur si elementë të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës i cili kërkon patjetër një analizë të dispozitës. Nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi e gjyqtarit, kryesisht në vendimet penale, në interpretimin të pavarur të normës nga fakti i çështjes, në rastet kur shkaqet e ankimit lidhen jo vetëm me elementë për të cilët është e nevojshme analiza dhe vlerësimi i provave, por edhe me elementë të cilat lidhen me mënyrën e aplikimit të ligjit procedural ose material mbi faktin konkret.

Në tërësi, referuar të gjitha të dhënave nga burimet e vlerësimit, ka rezultuar që gjyqtari ka shfaqur aftësi të mira në drejtim të interpretimit të ligjit, kryesisht atij material civil e në disa raste edhe atij penal, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Por duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, nuk është evidentuar e njëjta shkallë kujdesi në interpretimin paraprak në drejtim të qëllimit, elementëve përbërës dhe zbërthimit të normës në çështjet penale. Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, kryesisht vendimet penale, norma përgjithësisht zbatohej drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa iu nënshtruar paraprakisht një zbërthimi dhe interpretimi individual të saj. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërit prej tyre. Për këtë arsye, nga ana ime si relatore është propozuar që shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues të vlerësohet mbi mesataren, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Ky është treguesi i parë për të cilën gjyqtari ka paraqitur konkluzionet e veta, të cilat duke qenë se gjyqtari nuk është po i citoj:

“Së pari, thotë, detyrimi i gjyqtarit në interpretimin e normës ligjore lidhet jo vetëm me natyrën, rrethanat e çështjes dhe kompleksitetin e saj, por edhe me çështjet që i shtrohen atij për vlerësim e interpretim. Jo në çdo rast çështja që shtrohet para gjykatës përmban ose përfshin problematika që lidhen me interpretimin ligjor, por në shumë raste

edhe çështje që kanë të bëjnë thelbësisht me vlerësimin e provave dhe rrethanave të saj." -Në fakt në projektraport, lidhur me këtë konstatim të gjyqtarit është evidentuar cilat janë çështjet që kanë qenë me vlerësim të provave dhe cilat janë çështjet që kanë qenë me interpretim të ligjit, ku nuk evidentohet zbërthimi i dispozitës. (Janë me footnotes vendimet në projektraport).

"Së dyti, për nga natyra e tyre çështjet civile shfaqin kompleksitet në raport me çështjet penale, duke qenë se çështjet civile përfaqësojnë një kuadër më të gjerë ligjor, përcjellin problematika dhe institute të ndryshme, duke qenë shumë herë e nevojshme të zbatohen parime të ndryshme të së drejtës që kanë të bëjnë me vendosjen hierarkike të normave, raportin mes normave të përgjithshme dhe atyre të posaçme, parimin e veprimit të normës në kohë etj. Veçanërisht referuar çështjeve civile të pronave, edhe për shkak të mënyrës se si është zhvilluar dhe ndryshuar legjislacioni, si dhe problematikave që ka shfaqur realiteti jonë, ato kanë vështirësi të shtuar dhe kërkojnë një interpretim shumë më të gjerë e të hollësishëm, përfshirë të instituteve të së drejtës të përfshira.

Në ndryshim nga sa më sipër, çështjet penale, dhe konkretisht ato që kanë qenë objekt vlerësimi, nuk kanë shfaqur një problematikë të tillë që i kërkon gjyqtarit të përdorë metodat e interpretimit të normës ligjore së identifikuar të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete." – Në fakt edhe gjyqtari pohon që ka një ndryshim midis kompleksitetit të çështjeve civile dhe atyre penale. Ai i ka kushtuar vëmendje shumë të theksuar dhe ka një cilësi shumë të lartë interpretimi dhe argumentimi për sa i përket vendimeve civile por në çështjet penale kjo vjen dhe zbehet, në aspektin që duke qenë një gjyqtar apeli, ku ngrihen pretendime për kualifikimin juridik, dispozita jo vetëm citohet por edhe analizohet. Kjo nuk ndodh në të gjitha vendimet. Duke pasur parasysh që ne kemi vetëm 15 vendime që vlerësojmë, por gjithsesi ky është të themi ai kampioni i vendimeve në të cilat vlerësuesi bazohet dhe arrin në konkluzionet e veta.

"Së treti, në rastin e vendimeve të analizuara gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe nuk ka evidentuar ndonjë problematikë në drejtim të mënyrës së zbatimit dhe interpretimit të ligjit, për rrjedhojë as nevojën për të bërë një interpretim të ndryshëm, më të zgjeruar ose më shterues." – Në fakt, ky komponent i ngritur në ankimin e gjyqtarit ka të bëjë me komponentin analitik në të cilin unë do ndalem më vonë, se çfarë ndodh me vendimet gjyqësore, ku gjyqtari edhe aty është vlerësuar në aftësinë mbi mesatare.

“Për të nxjerrë kuptimin dhe përmbajtjen e vërtetë të normës, gjykatat përdorin disa lloj interpretimesh, sikundër është ai historik, sistematik, qëllimor, pajtues, gjuhësor të gjitha njëkohësisht ose të ndërthurura disa prej tyre. Në çdo rast, gjykata duhet të shpjegojë se si i ka zbatuar dhe përdorur konkretisht këto metoda interpretimi dhe ajo është e detyruar të elaborojë në mënyrë të qartë dhe logjike zbatimin e tyre në rastin konkret, për të mbështetur më pas konkluzionet e saj. Kjo merr akoma më tepër rëndësi në aspektin e përmbushjes së kritereve dhe respektimin e garancive të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në vendimet objekt vlerësimi, nga ana ime si relator nuk është evidentuar ndonjë paqartësi në zbatimin ose interpretimin e normës, çka do të sillte nevojën e përdorimit të këtyre metodave interpretative.” – Është në fakt një interpretim individual i gjyqtarit për arsyen se pse nuk ka bërë zbërthimin e normës.

“Së pesti, lidhur me vlerësimin e bërë në faqen 44 të projektraportit, në vendimet penale të sipërcituara nuk ka pasur raste të zbatimit të instituteve të “uljes së dënimit nën minimum” ose të “pezullimit të ekzekutimit” dhe në këtë këndvështrim nga ana e gjykatës nuk është bërë një interpretim i këtyre instituteve, për më tepër i dallimit mes tyre.” – Në fakt ka një vendim gjyqësor që është cituar, madje-madje ka qenë vendim gjyqësor i zgjedhur nga ana e gjyqtarit (vendimi nr. 617, i datës 24.07.2015), ku nga shkaqet e ngritura në ankim konsistonin kryesisht me mënyrën e vuajtjes së dënimit dhe thirreshin për zbatim në ankim nenet 59 që kishin të bënin me pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe neni 53 që kishte të bënte me uljen e dënimit nën minimum. Nuk gjejmë në vendim gjyqësor, ka vetëm konsiderata të përgjithshme, dallimin midis dy instituteve, sepse ulja e dënimit nën minimum është tjetër nga pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë e të pandehurit. Gjyqtari e pranon dallimin por thotë që nuk ka pasur raste. Në fakt vendimi është vendim i zgjedhur prej tij, ku është bazuar edhe relatori për të arritur në këtë konkluzion.

Duke qenë se konkluzioni im si relatore bazohet në të njëjtat akte dhe kundërshtimet e gjyqtarit janë perceptime të mënyrës se si ai e vlerëson këtë komponent, unë nuk kam propozime të ndryshme nga ajo që kam propozuar në projektraport sa i përket nivelit të aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimit të propozuar. Pra i mbetem përsëri këtij propozimi me vlerësimin e aftësisë së gjyqtarit mbi mesatare dhe me pikëzimin me 20 pikë.

Për sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit” , në tërësi

janë të pasqyruara edhe në projektvendim, gjyqtari ka aftësi shumë të mira të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, thjeshtësisë së shprehjes së mendimit, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit si dhe në rrjedhshmërinë e paraqitjes së mendimit juridik. Do thosha që është si një përrallë, vendimi rrjedh natyrshëm dhe është i kuptueshëm jo vetëm për njohësit e ligjit por edhe për përdorues të tjerë të gjykatës dhe për qytetarin.

Për sa i përket "Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit", në tërësi evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe i kushton rëndësi evidentimit të fakteve të çështjes, analizës së tyre, aplikimit të ligjit mbi to dhe paraqitjen e konkluzioneve të arritura mbi bazën e kësaj analize. Gjyqtari përdor një metodë të qëndrueshme në strukturimin e vendimit në përmbajtje të vendimeve e cila evidenton logjikën e arsyetimit, pavarësisht se kjo nuk rezulton tërësisht në aspektin vizual të tyre. Edhe pse nuk ka një ndarje me tituj, në fakt ndarja me paragrafë dhe mënyra logjike se si parashtrohet vendimi, e bën strukturën e vendimit të qëndrueshme dhe të kuptueshme për ata që lexojnë vendimin. Për këtë arsye propozohet nivel shumë i lartë aftësie (10 pikë).

Për sa i përket cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik, i cili është treguesi i dytë për të cilin gjyqtari ka kundërshtimet e tij. Nga ana ime si relatore, në vendimet e analizuara rezulton përgjithësisht një nivel shumë i mirë arsyetimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal objekt shqyrtimi, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore për zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përshkrimit të fakteve të çështjes, zhvillohet mbi bazën e një analize logjike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal, duke integruar këto elementë në çdo rast me faktet e provuara në gjykim, të cilat edhe në rastet kur pranohen se janë vlerësuar drejt nga gjykata e shkallës së parë, rimerren në shqyrtim dhe analizohen nga gjyqtari gjatë gjykimit në apel, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të tij për zgjidhjen e çështjes dhe vlerësimit për bazueshmërinë ose jo të secilit shkak ankimi (duke qenë se bëhet fjalë për një periudhë që Kodi i Procedurës Penale nuk e kishte të shprehur tekstualisht që

gjykata e apelit shqyrton mbi bazën e kufijve të ankimit, por edhe në gjykimin në apel ndodhte në fakt një vlerësim tërësor i çështjeve, rishqyrtim i çështjes). Në pjesën më të madhe të vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes, përcaktimi në mënyrë të shprehur i thelbit të mosmarrëveshjes ose çështjes penale objekt shqyrtimi, duke orientuar më pas analizën e faktit dhe të ligjit në funksion të mbështetjes së konkluzioneve mbi shkaqet e ankimit dhe zgjidhjen në tërësi të çështjes. Në pjesën tjetër të vendimeve burim vlerësimi nuk rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentimit logjik pasi komponenti analitik bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, pa u ndërthurur në çdo rast me një vlerësim të pavarur të Gjykatës së Apelit mbi shkakun e ngritur në ankim. Në këto raste, edhe pse konceptet ligjore evidentohen, ato jo gjithmonë analizohen në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak-pasojë, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjes dhe shkaqet e ankimit. Çfarë dua të them me këtë? Është ajo që ndodh rëndomë në fakt në qoftë se shohim në vendimet e gjykatave të apelit. Vendimet e gjykatave të apelit në disa raste nuk kanë një interpretim të pavarur të gjykatës së apelit mbi shkakun e ankimit, pra shkaku i ankimit ndodh, evidentohet dhe e gjen me një fjali: “Drejt ka vendosur gjykata e shkallës së parë për këtë konstatim”, pa pasur një interpretim të pavarur të vlerësimit të gjyqtarit të apelit në rastet kur shkaku i ankimit në fakt i referohet një elementi të caktuar të vendimmarrjes. Nuk e gjejmë pothuajse këtë. Arsyetimi i vendimeve në fakt është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse duke i analizuar ato, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, në tërësi si pjesë e analizës tërësorë mbi zgjidhjen e çështjes.

Janë evidentuar edhe këtu edhe vendimet ku ka shkallë të lartë analize penale dhe ato civile dhe si konkluzion, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport me natyrën komplekse ose jo të çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesataren në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Rezulton se vendimet gjyqësore, në varësi të natyrës komplekse ose jo të tyre dhe shkaqeve të ankimit, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumente të lidhura me njëri-tjetrin duke u ndalur në evidentimin e lidhjes shkak pasojë, në raport me konkluzionin për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari i

kushton rëndësi marrjes në analizë së pretendimeve të ngritura në ankim duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështje të procedurës ashtu edhe për themelin e zgjidhjes së saj. Megjithatë, duke i vlerësuar vendimet burim vlerësimi në tërësinë e tyre, nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik, pasi komponenti analitik i arsyetimit, në një pjesë të vendimeve është i dominuar nga përshkrimi dhe analiza e faktit, pa u ndërthurur me interpretimin e ligjit të zbatueshëm dhe më tej, dhënien e arsyeve për mënyrën e zbatimit të tij mbi faktin konkret. Edhe pse vendimet janë gjithëpërfshirëse referuar shkaqeve të ngritura në ankim, të cilat marrin përgjigje, kjo e fundit jo gjithmonë bazohet në një vlerësim të pavarur mbi pretendimet e ngritura si shkak ankimi, duke u mjaftuar me konkluzionin se qëndrimi i mbajtur nga gjykata e shkallës së parë është i të drejtë. Për këtë arsye, kam propozuar shkallën e aftësisë mbi mesatare dhe pikëzimin me 20 pikë.

Edhe ky komponent është kundërshtuar nga ana e gjyqtarit i cili kërkon pikëzimin maksimal duke u shkrehur se:

"Në vendimet e mia si gjyqtar kam treguar kujdes që ato, si formalisht, pra në lidhje me strukturën, ashtu edhe në substancë, pra në lidhje më analizën e çështjes, të përmbajnë jo vetëm elementet formale që kërkojnë dispozitat procedurale, por edhe një analizë të qartë, logjike dhe shteruese të çështjes dhe pretendimeve të parashtruara në ankim. Jam kujdesuar që vendimet të kenë një zhvillim të tillë, në formë dhe përmbajtje, që të tregojnë jo vetëm faktet dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykata më e ulët, por të tregojnë në mënyrë të qartë se përse është arritur në përfundimin e shprehur në dispozitiv dhe përse pretendimet e parashtruara në ankim nuk mund të pranohen, pra të përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke respektuar standardet që kërkon një vendim i arsyetuar.

Edhe referuar jurisprudencës kushtetuese, e cila ka elaboruar këtë standard si element të së drejtës për proces të rregullt, plotësimi i tij vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore përmbushin në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Në këtë drejtim vlerësohet nëse vendimet janë logjike, kanë kundërthënie, përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respektojnë të gjitha elementet që kërkon një vendim i arsyetuar.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, si dhe

masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit. Po ashtu, në linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së, ajo ka theksuar se ky detyrim nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse dhe se masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e tij. Arsyetimi i kufizuar në mënyrë të nënkuptuar evidenton se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse ligjore që është kusht për pranimin e kërkesës. Kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim i kufizuar nuk e cenon procesin e rregullt ligjor (është në fakt citimi i dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese).

Referuar standardeve të mësipërme, jo në çdo rast një vendim gjyqësor duhet të përmbajë zhvillim të koncepteve ligjore dhe analizën e koncepteve apo instituteve të ndryshme, në rast se

kjo gjë nuk është pretenduar, ose nuk rezulton e nevojshme për të arritur në një përfundim të drejtë të çështjes.

Duke iu referuar përmbajtjes së vendimeve të sipërcituara, të cilat kanë qenë objekt vlerësimi i këtij projektraporti, mendoj se vendimet janë të arsyetuara dhe plotësojnë jo vetëm elementet formale të strukturës, por përmbajnë edhe analizën e çështjes dhe të pretendimeve, si dhe vlerësimin në lidhje me bazueshmërinë e shkaqeve të parashtruara në ankim, ndërkohë që nuk janë paraqitur çështje të ndërlikuara të ligjit apo të faktit që do të duhet të impononinë një analizë më të detajuar.” - Prandaj kërkon dhe pikëzimin maksimal gjyqtari për këtë tregues.

Ky është këndvështrimi se si gjyqtari e vlerëson punën e vet. Sigurisht që nuk vihet në diskutim fare këtu elementi i arsyetimit të vendimit në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Vendimet sigurisht që janë të shumta, janë të arsyetuara dhe nuk do ishte pikëzimi mesatar po të vihej në diskutim arsyetimi i vendimit. Në vlerësimin tim nuk mund ta bëjmë as ne se nëse vendimi është i arsyetuar apo jo vlerësohet nga një gjykatë më e lartë, por këtu vlerësohet shkalla e cilësisë dhe aftësisë së gjyqtarit referuar komponentit analitik dhe argumentimit logjik.

Janë të evidentuara në projektraport arsyet për të cilat aftësia e gjyqtarit është vlerësuar mbi mesatare. Gjithsesi ky është një vlerësim i pavarur që mund të bëjë secili nga ne.

Përfundimisht për kriterin e parë “Aftësitë profesionale”, si relatore e çështjes

kam propozuar nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 90.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”, për asnjë nga treguesit gjyqtari nuk ka kundërshtime. Unë do i citoj në mënyrë të përmbledhur duke qenë se janë edhe burimet e vlerësimit në fakt të cunguara për sa i përket të dhënave statistikore. Ne bazohemi vetëm në të dhënat statistikore që kemi në dosjen e rivlerësimit dhe nuk marrim statistika të tjera sipas akteve nënligjore. Nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar tej afatit ligjor, 15 pikë.

“Standardi minimal kohor”, rezulton që të gjitha çështjet janë shqyrtuar brenda standardit minimal kohor të zbatueshëm, pikëzimi 5 pikë (përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit është 0%).

“Koha mesatare e çështjeve”, të gjitha çështjet sipas kategorisë janë shqyrtuar në një kohëzgjatje më të shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 muajsh që parashikohet për gjykatat e apelit nga dita e nxjerrjes për gjykim. Kështu që koha mesatare është vlerësuar me 5 pikë, më e shkurtër se standardi minimal.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, dua të theksoj që gjatë kësaj periudhe gjyqtari ka ushtruar edhe anëtarin e Kolegjit Zgjedhor dhe për këtë shkak ai ka qenë i angazhuar edhe në çështje të Kolegjit Zgjedhor por në cilësinë e relatorit ka vetëm një çështje. Në vitin 2014 janë caktuar 360 çështje, ka përfunduar 342 dhe një çështje në Kolegjin Zgjedhor. Në vitin 2015 janë caktuar 255, ka përfunduar 243 çështje dhe në Kolegj Zgjedhor 4 çështje. Në 2016 – 277 çështje (përfunduar 264 çështje) dhe 1 çështje në Kolegj Zgjedhor. Në total për gjithë vitin 2016 ka 278 çështje. Duke bërë rendimentin apo llogaritjen matematikore si raport midis çështjeve të caktuara dhe çështjeve të gjykuara, të gjykuara dhe të caktuara në fakt, raporti rezulton në masën 95.2%. Por vlerësuesi në vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit nuk mbështetet vetëm në analizën matematikore por bën një analizë logjike të të dhënave statistikore. Nga kjo analizë logjike, referuar parashikimeve që bën Metodologjia e Pikëzimit, ngarkesës së gjyqtarit në gjykimet me trupat gjykues me 3 gjyqtarë në gjykatën e Apelit, angazhimin e tij si anëtar i Kolegjit Zgjedhor si dhe faktin se çështjet civile për gjykim në gjykatat e apelit në këtë periudhë nxirreshin/ ishte atribut i kryetarit të gjykatës dhe jo nga ana e gjyqtarit, kam vlerësuar se për këtë tregues niveli i pikëzimit që përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarit duhet të rritet me një shkallë, dhe duhet të pikëzohet me pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit” është në të gjitha rastet më e shkurtër se

afati 30-ditor i rekursit që ne kemi pranuar, rezulton 18.2 ditë për çështjet civile dhe 15 ditë për çështjet penale, 1 ditë çështjet e kërkesave të hetimit paraprak. Pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket "Numrit mesatar të seancave dhe kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për evidentimin e seancave joproduktive". Numri mesatar i seancave janë të përshkruara të gjitha seancat në dosje (11 dosjet që janë marrë në analizë), rezulton të jetë 3.2 seanca gjyqësore dhe në të gjitha rastet gjyqtari ka marrë masa për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, të cilat ju e dini në apel, duke qenë se apeli nuk ka një fazë përgatitore të çështjes, çështjet që vijnë mbi bazë ankimi, ndodhin për shkak të njoftimit të palëve, njoftimit të mbrojtësve, realizimit të njoftimit të rregullt të të pandehurit në gjendje të lirë apo nëpërmjet kërkimit nga policia gjyqësore, njoftimit me afishim me shpallje, dhe janë kryesisht çështje që lidhen me njoftimin e rregullt të të pandehurit në gjendje të lirë dhe për marrjen e dokumentacionit në rastet kur gjykata e apelit ka konsideruar riçeljen e shqyrtimit gjyqësor. Në një rast kemi shtyrje sepse ka hequr dorë një nga anëtarët e trupit gjykues. Gjithsesi numri i seancave është 3.2 dhe në bazë të metodologjisë është kaluar vetëm me 0.2 (që është tejkalim i papërfillshëm), por pavarësisht numrit të këtyre seancave, gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Për këtë arsye është vlerësuar pikëzimi maksimal 15 pikë.

Për sa i përket "Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor", gjyqtari është vlerësuar po kështu me shkallë shumë të lartë aftësie me 20 pikë. Edhe këtu është ai problemi që është konstatuar edhe gjatë procesit të vetingut, që mungojnë ato vendimet e nxjerrjes së çështjeve për gjyq nga ana e gjyqtarit (në çështjet civile), por kjo është një gjë që tashmë e kemi kaluar. Bëhet nëpërmjet urdhërimit dhe aq më tepër që nxjerrja e çështjeve civile bëhej nga kryetari dhe nuk kishte se si gjyqtari të dispononte me vendim për caktimin e datës së gjyqit. Për këtë arsye është 20 pikë.

Administrimi i dosjes gjyqësore si dhe saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes, pikët maksimale, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Përfundimisht për kriterin e dytë të "Aftësive organizative të gjyqtarit", gjyqtari propozohet të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket "Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale" – Në të gjitha

relacionet e ish-Inspektoratit dhe ato të ILD-së nuk ka elementë që lidhen me etikën në punë apo me integritetin e gjyqtarit. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk evidenton elementë që lidhen me etikën dhe integritetin e gjyqtarit. Për këtë arsye, për shkak të burimeve të vlerësimit, qoftë për sa i përket etikës në punë, qoftë për sa i përket integritetit për shkak edhe të parimit të prezumimit, është propozuar niveli maksimal, pasi nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit apo angazhimin dhe përgjegjshmërinë e tij në funksion.

Për sa i përket të "Paanësisë", "Përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese", është propozuar pikëzimi maksimal sepse nga të gjitha burimet e vlerësimit rezulton se në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikim me palët në proces ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. E njëjta gjë edhe për "Numrin e lartë të kërkesave të pranuara për përjashtimin e gjyqtarit", nuk ka asnjë kërkesë. Kështu që numri vlerësohet i pakonsiderueshëm.

Pikët maksimale për kriterin e tretë, "Shkëlqyeshëm" (100 pikë).

Për sa i përket kriterit të katërt "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional", propozohet shkallë e lartë aftësie dhe pikëzim maksimal referuar të dhënave të burimeve të vlerësimit për komunikimin e qartë dhe transparent me palët, me administratën, për respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, për aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët duke shkëmbyer edhe njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, si dhe për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore (shkallë shumë të lartë aftësie). Është propozuar pikëzim maksimal.

Për sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarit në programet e formimit vazhdues, duke marrë parasysh të gjithë analizën që kemi bërë sipas ligjit të vjetër (nuk dua të ndalem përsëri), numri i trajnimeve, duke qenë se sipas ligjit të vjetër ligji parashikonte vetëm kufij maksimal të pjesëmarrjes por jo kufij minimal, 11 ditë trajnimi janë pikëzuar me 20 pikë.

Për sa i përket disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional apo për angazhimet në veprimtari ndërinstitucionale nuk ka pasur të dhëna, prandaj pikëzimi është me 3 pikë.

Për sa i përket publikimeve ligjore akademike nuk ka të dhëna, është pikëzimi 0 pikë.

Përfundimisht për kriterin e katërt të "Aftësive personale dhe angazhimit

profesional” është propozuar niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Në përfundim, në cilësinë e relatores, pasi analizova edhe kundërshtimet e gjyqtarit, nuk ka ndryshim të propozimit për shkallë aftësie apo pikëzim dhe mbetem në “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, 90 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm"; “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm"; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm"; “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Në total, vlerësimi i përgjithshëm si nivel është "Shkëlqyeshëm", pikët 381.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj për relatimin e projektraportit.

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.

Alban Toro: Kam unë një pyetje.

...Më 18.05.2022 ka pasur një vendim arkivimi nga ILD-ja. Është i formës së prerë?

Brikena Ukperaj: 18.05.2022. Për çfarë faqe e ke tek raporti?

Alban Toro: Faqja 5, paragrafi i tretë.

E kam shkresa 1356/1 prot., datë 18.05.2022.

Brikena Ukperaj: Përfundimi i hetimit disiplinor.

Po, 18.05.2022 “Për arkivimin e shkresës...”

Ne kemi marrë vendimet e arkivimit, por i kemi dërguar. Këtë e kemi bërë për të gjithë gjyqtarët. Për asnjë gjyqtar nuk kemi verifikuar nëse vendimet e arkivimit janë të prishura apo jo, por i kemi dërguar në mënyrë të përsëritur para se të mbyllnim shqyrtimin e hetimit administrativ, ILD-së, nëse ka pasur apo jo (dhe vendimi është mbyllur me vendimin e datës 15.09.2022, brenda afatit), nëse ka pasur ankime apo vendime të ndryshme dhe ata kanë thënë që deri në këtë moment ne nuk kemi.

Alban Toro: Të pyesim edhe Komisionin për një konfirmim.

Brikena Ukperaj: Këtë gjë Alban nuk e kemi bërë për asnjë gjyqtar, e para, dhe e dyta, mund të ndodhë që për të gjithë gjyqtarët që kemi mund të ketë... ose kështu mund të presim, të pezullojmë punën dhe të presim përgjigjet. Por s'e kemi mbajtur për asnjë. Unë gjithsesi, duke qenë se bëhet fjalë për kandidat në Gjykatën e Lartë, deri ditën e fundit i kam kërkuar ILD-së informacion, u kemi kërkuar që të trajtohej në përparësi kjo çështja që na kishin sjellë pezullimin e hetimit disiplinor "na sillni nëse keni materiale të tjera apo jo për këtë periudhë vlerësimi", dhe nuk na kanë dërguar. Megjithatë edhe nëse do ketë, gjyqtari do vlerësohet për 2021, kështu që në qoftë se do dalin gjatë kësaj kohe të dhëna të tjera që duhet të vlerësohen në drejtim të etikës apo jo, i marrim në shqyrtim.

Alban Toro: E kemi këtu Komisionin nuk është se përbën ndonjë problem të madh të merrnin një konfirmim. Se mundet Komisioni të ketë arritur dhe të ketë konkluduar diçka nëse ka një ankim për arkivim. Nëse s'ka pasur është shumë kollaj që të themi që Komisioni nuk ka pasur një ankim.., pavarësisht se diçka më thotë në vesh që për këtë çështje apo për çështje të tjera (nuk e mbaj mend me thënë të drejtën, se më ka rënë rasti dhe fati të jem pjesë e këtij Komisioni) por nuk di ta konfirmoj nëse bëhet fjalë për këtë pjesë apo jo.

Naureda Llagami: Alban, propozimi konkret.

Alban Toro: Bëra pyetje, s'bëra propozim.
Pyetja ishte a është i formës së prerë apo jo.
Më tha që ka pyetur ILD-në dhe i ka thënë që nuk kemi ankim.

Naureda Llagami: Gjë tjetër?
Sugjerim? Po!

Marçela Shehu: Duke përgëzuar relatoren dhe punën, kam vetëm një propozim, nuk është mendim ndryshe, por vlerësim ndryshe. Për një nga treguesit, tek "Aftësitë profesionale", "Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik", unë do propozoja që gjyqtari të vlerësohej maksimalisht, pra jo me 20, por me 25 pikë. Ky është qëndrimi im.

Brikena Ukperaj: Është treguesi i fundit i kriterit të parë. Tek shtojca është "1Bc". Apo jo?

Naureda Llagami: Atëherë, duke qenë se s'kemi më sugjerime, propozoj që të hedhim në votim propozimin e Marcelës që nga 20 ta bëjmë 25 "Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik".

Ilir Rusi: Kundër propozimit të Marçelës.

Irena Plaku: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord me propozimin e zonjës Shehu.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin e zonjës Shehu. Vetëm do shtoja një koment në lidhje me këtë. I referohem faktit që gjyqtari {...} mund të jetë një nga gjyqtarët më të vjetër që ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, me një përvojë ndoshta mbi 20-vjeçare dhe për mua bën sens propozimi i zonjës Shehu në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit pasi është një gjyqtar që ka një përvojë jashtëzakonisht të gjatë në Gjykatën e Apelit Durrës. Për këtë arsye besoj se duhet që, sipas vlerësimit tim, të mbështetet propozimi i zonjës Shehu.

Naureda Llagami: Kundër.

Kalojmë në miratimin e raportit në tërësi, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Vlerësimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord me rezervën e mëparshme.

Alban Toro: Pjesërisht dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord, përveç "Cilësisë dhe analizës", nëntreguesi "c".

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Pjesërisht dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pikat 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër z. {...}, për shkak të dorëheqjes. (relatore znj.Marçela Shehu).[1]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

[1] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër z. {...}, për shkak të dorëheqjes. (relatore znj.Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës, që ka të bëjë me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër z. {...}, për shkak të dorëheqjes. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin "Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër z. {...}, për shkak të dorëheqjes së tij.

Ndërkohë që Këshilli i Lartë Gjyqësor po vijonte procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor, ndër të tjera edhe për zotin {...}, kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, më datë 17.10.2022 z. {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë

Gjyqësor kërkesën për dorëheqje nga pozicioni i punës si kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Ndërkohë, në vijim të kërkesës për dorëheqje, me datë 27.10.2022, z. {...} ka depozituar pranë Këshillit dokumentacion shtesë rreth kërkesës për dorëheqje, duke kërkuar gjithashtu dhe përshpejtimin e shqyrtimit të saj për faktin se: "Kërkesa për dorëheqje është bërë për shkak të daljes fitues si kandidat në procedurë konkurrimi për pozicionin vakant për inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe jam në pritje të vendimit të emërimit..., për rrjedhojë më duhet të bëj dorëzimin e detyrës pas vendimmarrjes së Këshillit....".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika c të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ka në kompetencë të tij ndër të tjera emërimin e kancelarëve të gjykatave. Në nenin 59, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 përcaktohet se: "Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor ...".

Ndërkohë, lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës dhe përfundimin e saj, në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016, parashikohet se: "3. Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësor është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën".

Në këtë dispozitë theksohet se ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil", përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Në nenin 64, të ligjit nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar, përcaktohet se: "1. Nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi...".

Sa më sipër, në kushtet kur për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga kancelari në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër z. {...}, vlerësohet se është vërtetuar një ndër

shkaqet ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës, sipas parashikimeve të nenit 64 të ligjit nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar, marrëdhënia e punës duhet të deklarohet e përfunduar për shkak të dorëheqjes së paraqitur.

Në këtë rast propozohet që dorëheqja e z. {...}, bazuar në arsyet e paraqitura prej tij t'i prodhojë efektet përpara afatit 30-ditor.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit është përcaktuar disponimi për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për z. {...}, për shkak të vërtetimit të një prej shkaqeve ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës.

Në pikën e dytë të projektvendimit është përcaktuar njoftimi i vendimit z. {...}, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Lidhur me krijimin e efekteve ligjore dhe hyrjen në fuqi, nga ne është propozuar hyrja në fuqi menjëherë, por gjithsesi nëse nga Këshilli vlerësohet ndryshe, atëherë mund të përcaktojmë një afat tjetër. Por ne vlerësuam që hyrja në fuqi menjëherë bën sens dhe ka vend në këtë rast për sa kohë ai kërkon një shqyrtim sa më të shpejtë të kërkesës dhe krijimin e efekteve sa më të shpejta për dorëheqjen e paraqitur prej tij. Ky është propozimi.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.

Nëse s'ka kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Hedhim në votim projekt-aktin sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, për shkak të dorëheqjes.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pikat 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt**:* Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 15.09.2022, 19.09.2022, 23.09.2022.[2]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

[2] Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

7. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 15.09.2022, 19.09.2022, 23.09.2022.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare respektivisht në datat 15.09.2022, 19.09.2022, 23.09.2022. Nuk e di nëse keni pasur mundësi që t'i konsultoni?

Propozoj miratimin e procesverbaleve.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 15.09.2022, 19.09.2022 dhe 23.09.2022.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pikat 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2022)

***Pika 8 shtesë e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[3]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

[3] Kjo çështje është shtesë në rendin e ditës dhe renditet e teta për shkak se pikat 6 dhe 7 të rendit të ditës i cili eshte shpërndarë për trajtim, u shtynë për një mbledhje tjetër (shih procesverbalin e çështjes së parë të rendit të ditës). Procesverbali është përmbledhje.

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu në sallë dhe online:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani, Elisa Stamo, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

3. Blerina Gjoka, BIRN.

RENDI I DITËS:

8 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit e cila u shtua në rendin e ditës lidhet caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi i cili parashtron shkurtimisht relacionin e përgatitur për caktim gjyqtari në **Gjykatën e Apelit Vlorë**, e cila ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët Iliba Bezati dhe Adelajda Gjuzi. Ka pengesë gjyqtari Laurent Fuçia dhe Genti Dokollari pasi janë shprehur respektivisht me vendimet e datave 08.04.2021 dhe 17.03.2022. Çështja konsiderohet me karakter urgjent pasi një prej të pandehurve ka paraqitur kërkesë për shuarje masë sigurimi.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë në pamundësi të zbatimit të

mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: znj. Irena Brahimi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Miranda Andoni.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Pikat 8 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor